



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT INSTITUTI PARLAMENTAR

Seminar me temë:

PARLAMENTI (KUVENDI) SI INSTITUCION THEMELOR I TË DREJTËS PARLAMENTARE

për studentët e universiteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Përmbajtjet e seminarit janë zhvilluar dhe realizuar nga Njësia për
Edukim dhe Komunikim e Institutit Parlamentar të Kuvendit të
Republikës së Maqedonisë së Veriut

Informacione të përgjithshme:

Instituti Parlamentar është njësi e veçantë organizative në Shërbimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut që funksionon si një qendër për hulumtim, edukim dhe informim, i themeluar mbi parimet e paanshmërisë, arritshmërisë dhe kredibilitetit.

Instituti Parlamentar, ndër të tjera, kryen aktivitete për edukim dhe informim të qytetarëve për punën dhe rolin e Kuvendit (në përputhje me qëllimin e tij strategjik për transparencën e Kuvendit ndaj publikut).

Gjatë vitit, është planifikuar të organizohen tre seminare njëditore për edukimin e studentëve të universiteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut me temë: **“Parlamenti (Kuvendi) si institucion themelor i të drejtës parlamentare”**. Aktivitetit është program i veçantë i Njesisë për Edukim dhe Komunikim të Institutit Parlamentar që realizohet si një punëtori në kohëzgjatje prej gjashtë orësh. Këto seminare do të dedikohen për studentë të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në universitetet e akredituara të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përparësi do të kenë studentët të cilët në kuadër të programit mësimor mësojnë një nga këto lëndë: E drejta parlamemntare, E drejta kushtetuese, Konstitucionalizmi, Sistemi politik, Organizimi i pushtetit dhe ngjashëm.

Përshkrimi i seminarit:

Aktiviteti edukativ është paramenduar të zbatohet në lloj të seminarit në kohëzgjatje prej gjashtë orësh. Seminari është një përpjekje për të përfshirë aspektet teorike të së drejtës parlamentare, me një fokus në zbatimin e tyre praktik. Qasja e trajnuesit është kombinim i prezantimit, fasilitimit (lehtësimit/ndihmës) dhe fidbekut (informatës kthyesë). Në seminar dominon një qasje interaktive, që paraqet përfshirjen e pjesëmarrësve nëpërmjet pyetjeve dhe diskutimeve dhe shkëmbimit të përvojave. Seminari bazohet në përvojën e trajnuesve, të cilët përveç njohurisë praktike si pjesë e shërbimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, posedojnë edhe njohuri akademike (teorike) nga sfera e caktuar.

Seminari fillon me vizitë të organizuar në pjesën solemne të Kuvendit, që përfshin vizitë të Sallës Maqedonia (Salla Plenare), Sallës Boris Trajkovski, Sallës së Ohrit, Sallës së Drugdhjendjes së thellë dhe hapësirave të tjera. Nëpërmjet vizitës, pjesëmarrësit kanë mundësinë që nga afër të njihen me hapësirën në të cilën punojnë deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Agjenda e seminarit përbëhet nga katër sesione tematike. Sesioni i parë i kushtohet historisë së parlamentarizmit në Maqedoni, kështu që studentët kanë

mundësinë të njihen me të kaluarën, proceset historike, ngjarjet dhe personalitetet që kanë lënë gjurmë në historinë e parlamentarizmit në Maqedoni.

Në sesionin e dytë, theksi vihet në organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, përkatësisht në atë se çfarë e bën Kuvendin organ përfaqësues të qytetarëve dhe bartës të pushtetit ligjvënës të Republikës. Qëllimi i sesionit është njohja e studentëve me rregullat sipas të cilave zhvillohet parlamentarizmi dhe veprimtaria e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sesioni i tretë kombinon qasjen teorike dhe praktike të trajnuesit gjatë shqyrtimit të pozitës juridike të deputetëve dhe roleve të ndryshme në të cilat mund të gjenden përfaqësuesit e popullit gjatë ushtrimit të funksionit të deputetit.

Gjatë sesionit së fundit, shqyrtohen kompetencat themelore të Kuvendit, me theks të veçantë në procedurën e miratimit të ligjeve.

Në kuadër të sesionit të dytë dhe të tretën do të përfshihen edhe deputetët e Kuvendit, në mënyrë që studentëve t'u tregohet edhe për aspektet e punës në Kuvend që do të jenë temë e shqyrtimit të sesioneve. Në këtë mënyrë studentëve do t'u mundësohet që në mënyrë të drejtpërdrejt të parashtrajnë pyetje dhe të diskutojnë me deputetët për punën dhe rolin e tyre në procesin demokratik, si dhe për tema të rëndësishme në fushën e parlamentarizmit.

Të gjithë pjesëmarrësve në këtë punëtori do t'u jepen certifikata për pjesëmarrje.

Instituti Parlamentar

Qëllimet e përgjithshme Afrimi i punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut te popullata e re, që do të kontribuojë në zhvillimin e ndërgjegjësimit të tyre për përfitimet e demokracisë dhe do t'i inkurajojë ata për kritikë dhe përfshirje shoqërore dhe politike.

Numri i pjesëmarrësve Dy fakultete, numri i pjesëmarrësve nga një fakultet është maksimum 14 studentë dhe një person përgjegjës (profesor ose asistent)

Koha: Tre herë në vit

Vendi: Qendra edukative e Instituti Parlamentar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Gjuha: Gjuha maqedonase me përkthim në gjuhën shqipe

Trajnues: Seminari do të realizohet nga trajnuesit e Njesisë për Edukim dhe Komunikim në Institutin Parlamentar.

Shpenzime: Pjesëmarrja në seminar është falas dhe përfshin materiale edukative falas, ushqim dhe pije freskuese gjatë evenimentit. Shpenzimet e transportit nga dhe deri në vendin e seminarit i mbulojnë vetë pjesëmarrësit.

Mënyra e paraqitjes: Çdo shkollë që do të paraqitet, emëron maksimum 14 studentë të cilët do të marrin pjesë në seminar dhe një person përgjegjës që do t'i shoqërojë. Paraqitja bëhet nëpërmjet platformës softuerike për paraqitje: seminari.sobranie.mk

Kontakti: E-mail: parl.inst@sobranie.mk
tel: 02/3182 - 227

Qëllimet e përgjithshme të seminarit:

Pas përfundimit të seminarit, pjesëmarrësit do të kenë mundësi:

- të njihen me të kaluarën, proceset historike, ngjarjet dhe personalitetet që kanë lënë gjurmë në historinë e parlamentarizmit në Maqedoni;
- të njihen me Rregulloren e Punës së Kuvendit si burim kryesor i të drejtës parlamentare dhe shprehje më e lartë e autonomisë së Kuvendit;
- të dinë përbërjen e parlamentit dhe faktorët që ndikojnë në përbërjen dhe strukturën e tij;
- të njihen me statusin e deputetëve, si dhe me natyrën dhe të drejtat që e përcaktojnë statusin e tyre në parlament;
- të identifikojnë organizimin e brendshëm të Kuvendit, të trupave të punës, grupeve të deputetëve, Kryetarit të Kuvendit, si dhe të organeve që udhëheqin me punën parlamentare;
- të kuptojnë kompetencat themelore të parlamentit;
- të dinë fazat e procedurës për miratimin e ligjeve dhe rolin e të gjitha palëve të përfshira në të njëjtën.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, seminarit do t'i përfshijë këto përmbajtje:

Përmbajtje	Kohëzgjatja
Vizitë e organizuar në ndërtesën e Kuvendit	60 minuta
Historia e parlamentarizmit në Maqedoni	45 minuta
Organizimi dhe funksionimi i Kuvendit	45 minuta
Pozita juridike e deputetëve	45 minuta
Funksionet themelore të parlamentit dhe procedura e miratimit të ligjeve	45 minuta
Vlerësimi dhe dhënia e certifikatave për pjesëmarrje në këtë seminar	15 minuta